



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 91-të, të mbajtur më 31.08.2023, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1250/1 të datës 22.02.2023, me pretendime kundër sekretarit gjeneral ----- dhe emërimin e kuadrove në ----- në institucione të ndryshme, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja përcaktoi se, në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Lënda me numër 12-1250/1 të datës 22.02.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Më 26 maj 2022, një parashtrues i njohur paraqiti denoncim me pretendime kundër sekretarit të përgjithshëm të ----- dhe emërimin e kuadrit në ----- në institucione të ndryshme dhe është formuar lënda me numër arkivi 12-1250/1 datë 22.02.2023.

Në denoncim, parashtruesi thekson se përpjekjet e /// për të siguruar ushqime për dhuruesit e gjakut janë ndërprerë nga disa persona.

Parashtruesi thekson se sekretari i përgjithshëm i ----- ----- me mandat te falsifikuar nuk raporton për fondet për dhurues gjaku qe rrjedh nga buxheti dhe nga Ministria e Shëndetësisë te kjo organizatë. Gjithashtu, thuhet se ky person nuk ka të dhëna nëse donacionet e dhëna kanë përfunduar tek

familjarët e të vrarëve në aksidentin në datën ----- . Më tej tregohet se ----- prodhon kaos me personelin e saj në këtë zonë. Gjegjesisht, thuhet se drejtori i -----  
----- ka njerëz të afërt që punojnë në institucione të tjera nga sektori i shëndetësisë, si dhe institucionet tjera dhe kanë keqpërdorur shuma të mëdha parash.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se i raportuari ----- nuk është zyrtar në kuptim të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, pas së cilës ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për çështjen në fjalë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Lidhur me pretendimet se personi ----- ka njerëz të afërt që punojnë në institucione të tjera, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka pretendime konkrete për konflikt interesi dhe pretendime të qarta ose indikacione për veprime të paligjshme ose të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e pushteteve publike dhe detyrave zyrtare.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B:K:SH

Miratoi: K:N anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROР  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Nënkryetar,  
Sofka Pejovska Dojçinovska**